

VENDIM
Nr. 940, datë 26.12.2012

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR AUTORITETIN RRUGOR
SHQIPTAR, TË MJEDISEVE DHE SIPËRFAQES 2735 M², NGA TRUALLI FUNKSIONAL I
PRONËS NR. 100, ME EMËRTIM “GRUP DEPO REP. USHT. NR. 5011/25”, TUJAN, TIRANË DHE
PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, të mjediseve dhe sipërfaqes 2735 (dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) m² të truallit funksional të pronës nr. 100, me emërtim “Grup Depo Rep. Usht. nr. 5011/25”, me vendndodhje në Tujan, Tiranë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas formularit standard të inventarizimit dhe planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për ta përdorur për nevoja urbanistike, ndërtimin e rrugës publike të Arbrit.

2. Mjediset dhe sipërfaqja 2735 (dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) m², të truallit funksional të pronës nr. 100, me emërtim “Grup Depo Rep. Usht. nr. 5011/25”, Tujan, Tiranë, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose ta japin në përdorim te të tretët.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave si klasa të veçanta)

Ministria e Mbrojtjes										
Komuna Dajt, Tirane										
Fusha e perdorimit te prones:										
Per Mbrojtjen										
A			B				C			
Nr	Zona Kadast Indeksi i hartes	Numeri pasuris	Emertesa e prones Vendodhja/ shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te prones	Adresa/ vendodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne M2 ose MI	Funksioni per te cilin perdoret prona	Enti me Pergjegjesi Administrative	Enti Perdorues Statusi Juridik i perdorimit	Te dhena te tjera shenime te veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
75			Komanda FT			17500 M2	Për Mbrojtjen	MM Rep.Usht. 8800 Tirane	Rep.Usht 8800 Tirane	
			Qesarak, Tirane	Zyrat e komandes	Qesarak, Tirane	643				2 kate
				Zyrat e logarise		119				
				Postoblloku		44				
				Batalioni Logjistik		176				
				Depo PH		192				
				Depo ushqimi		192				
				Depo		192				
				Depo		192				
				Truproje		114				

			Tunel municioni			1238							
			Truall			35722							
101			Rep.5011 Depo Ushqimit			15416 M2	Per Mbrotjtjen	MM Rep. Nr.5010 Tirane	Rep.Ushit. Nr.5011, Tirane				
			Rrapl Treshit, Tirane		Tirane	530							
			Park telaje			237							
			Depo			420							
			Depo			272							
			Depo			210							
			Depo			210							
			Depo			371							
			Depo			392							
			Depo			512							
			Depo			300							
			Depo			300							
			Ish depo kripe			122							
			Truall			11540							
102			Qendra e Nderlidhjes			9791 M2	Për Mbrotjtjen	MM Rep.Nr. 2001 Durrës	Rep.Ushit Nr.2001 Durrës				
			Linxë, Tirane		Tirane	101							
			Q.nderlidhje tip tunel			66							
			Depo nderlidhje kazerm.										
			Lokal motorrash			27							
			Banjo WC			9							
			Depo rikupero			130							
			Menze kuzhine fjetline kabinet			141							
			Depo qymyri			24							
			Truall			9395							
103			Bateria AKA ish rep.4225/2			24000 M2	Per Mbrotjtjen	MM Rep.3400 Tirane	Rep.Ushit. 3030 Tirane				Dhene per banese

PLANVENDOSJA E REP. USHT. NR. 5011/25
TUJAN (PRONA 100)

